



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. Q-26330/12 prot.

Tiranë, më 26/11 / 2021

Lënda: Kthim përgjigje ✓

QENDRA "RES PUBLICA"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-26330, datë 15.11.2021 dhe ka kaluar për shqyrtim edhe te Policia Bashkiake, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. Q-26330/1, datë 24.11.2021 si vijon:

"Në përgjigje të shkresës tuaj, në lidhje me kërkesën për informacion, mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar fruta-perime, pranë bulevardit "Bajram Curri", (zona Vasil Shanto – ish stacioni i fundit i linjës së Tiranës së Re), ju bëjmë me dije se:

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 130, datë 15.11.2018 "Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë Tiranë", shërbimet e Policisë Bashkiake, në mënyrë periodike, ushtrojnë çdo ditë kontroll në hapësirat publike, që shfrytëzohen nga subjektet tregtare, që shfrytëzojnë hapësirat publike në territorin e Bashkisë Tiranë. Gjatë kontrollit të ushtuar ndaj subjekteve tregtare me veprimtari ekonomike fruta-perime, të cilat shfrytëzojnë hapësirat publike në bulevardin "Bajram Curri" (zona Vasil Shanto – ish stacioni i fundit i linjës së Tiranës së Re), në rastet e konstatimit të zënies së trotuarëve me tezga, arka apo mjete të tjera rrethanore janë marrë 4 masa administrative (gjoha), për kundërvajtjet e kryera, duke u bërë i mundur dhe lirimi i menjëhershëm i këtyre hapësirave publike.

Për sa më lart, respektimi i distancave për dhënie e lejeve të subjekteve fruta-perime si dhe dhënia e lejes për zënien e hapësirave publike apo informacioni mbi marrëveshjen e Bashkisë Tiranë për parkimin e mjeteve të transportit nuk janë kompetencë ligjore e Policisë Bashkiake".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerta Goxha



1913
154/2

BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. Q-26330/4 prot.

Tiranë, më 07/12 / 2021

Lënda: Kthim përgjigje

✓

QENDRËS "RES PUBLICA"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-26330, datë 15.11.2021 dhe ka kaluar për shqyrtim edhe te Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Licensimit dhe Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. Q-26330/3 prot., datë 03.12.2021 si vijon:

"Në përgjigje të kërkesës suaj, me anë të së cilës kërkohet informacion mbi subjektet tregtare që ushtrojnë aktivitet në bulevardin "Bajram Curri" (zona Vasil Shanto/ish-stacioni i Tiranës së Re), nuk rezulton të jenë pajisur subjekte me leje ushtrim aktiviteti në hapësirë publike-tregje të miratura nga Bashkia Tiranë).

Referuar sa më sipër po e përcjellim shkresën për kompetencë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerta Coxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
DREJTORIA OPERACIONALE DHE TEKNIKE

Nr. 269110/prot.
2

Tiranë, më 23.12.2021

Lënda: Kthim përgjigje

Qendra "Res Publica"

Adresa: Blv. Gjergj Fishta, Nd.24, H.3, Ap.7

Tiranë

I nderuar z.Matlaja,

Në përgjigje të kërkesës suaj nr.prot.154/21 drejtuar Bashkisë Tiranë dhe protokolluar me Nr.Q-26330, datë. 15.11.2021, e cila e ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore me prot.nr.269110 dt.09.12.2021, Ju informojmë si më poshtë vijon:

Në zbatim të Ligjit Nr.9632 dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" me ndryshimet përkatëse, V.K.B nr.158, dt.26.12.2019 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" i ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimit nr.130, datë 15.11.2018 të Këshillit Bashkiak për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës"

Subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtarë fruta-perime në adresën Blv."Bajram Curri"(Rr: "Vasil Shanto" ish-Stacionit i fundit "Tiranës së Re"), sipas të dhënave në sistemin tonë informatik rezultojnë të tarifuar për shfrytëzimin e hapësirës publike subjektet si më poshtë:

1. Juxhino Karaj me nipt L31923003V, është tarifuar 22m² sipërfaqe hapësirë publike, subjekti i pajisur me Leje prot.nr.117441 datë.24.08.2020.
2. Petrit Leta me nipt L62204032P, është tarifuar 5m² sipërfaqe hapësirë publike, subjekti i pajisur me Leje prot.nr.219881 datë.23.11.2017.
3. Ervin Jolla me nipt L52115076L, është tarifuar 26m² sipërfaqe hapësirë publike, subjekti është pajisur me Leje prot.nr.225972 datë.10.08.2021.
4. Edvin Sulejmani me nipt M02007016O, është tarifuar 30m² sipërfaqe hapësirë publike, subjekti nuk është pajisur me Leje shfrytëzimi për hapësirën publike, pasi nga muaji Shtator me Vendim Nr.35982/1 datë.22.09.2021 të Kryetarit të Bashkisë, lejet për shfrytëzimin e hapësirës publike janë pezulluar për një periudhë kohore 6 (gjashtë) mujore.
5. Dashamir Koçi me nipt L02205034H, i është tarifuar 4m² sipërfaqe hapësirë publike. subjekti është pajisur me Leje prot.nr.148906 datë. 13.07.2021.
6. Shpetim Turhani me nipt L52026002F, është tarifuar 8.42m² sipërfaqe hapësirë publike, subjekti është pajisur me Leje prot.nr.9351 datë. 10.03.2017.

7. Gentian Gjona me nipt L21919025H, është tarifuar 35.1m² sipërfaqe hapësire publike, subjekti është pajisur me Leje prot.nr.104804 datë. 10.04.2019.
8. Razije Koçi me nipt L72411046E, është tarifuar 1.4m² sipërfaqe hapësire publike, subjekti është pajisur me Leje prot.nr.206555 datë.30.12.2020.
9. Ervis Drita me nipt L62214003G, është tarifuar 80m² sipërfaqe hapësire publike, Subjekti nuk është pajisur me Leje shfrytëzimi për hapësirën publike, pasi nga muaji Shtator me Vendim Nr.35982/1 datë.22.09.2021 të Kryetarit të Bashkisë, lejet për shfrytëzimin e hapësirës publike janë pezulluar për një periudhë kohore 6 (gjashtë) mujore.
10. Big Vasil Shanto me nipt L21520015Q, nuk ushtron aktivitet tregtarë në hapësirë publike por në pronë të regjistruar me kod vendor 130594 në emër Eduart Gjini.

Subjektet nuk janë pajisur me Lejen e shfrytëzimit të hapësirës publike, pasi nga muaji Shtator me Vendim Nr.35982/1 datë.22.09.2021 të Kryetarit të Bashkisë, Lejet për shfrytëzimin e hapësirës publike janë pezulluar për një periudhë kohore 6 (gjashtë) mujore.

Për subjektet që ushtrojnë aktivitet fruta-perime në tezga (subjektet ambulantë) janë objekt kontrolli nga Policia Bashkiake.

Në bazë të V.K.B nr..130 datë.15.11.2018, në lidhje me shkeljet për përdorimin e hapësirës publike masa administrative (gjoha) merren nga Institucionet vendore siç janë Policia Bashkiake, Inspektoriati Mbrojtjes Territorit, Agjensia Mbrojtjes Konsumtorit.

Informacion më të detajuar në lidhje me masat administrative për përdorimin e hapësirës publike mund ti drejtoheni organeve kompetente të sipërcituara.

Bashkalidhur do gjeni 7 (shtatë) kopje të lejeve të miratuara, para daljes Vendimit të Kryetarit të Bashkisë për pezullimin për një periudhë kohore 6 (gjashtë) mujore.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arli Naska

